

Vendim

Nr.507, datë 08.08.2007

Për miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në shqipëri, blloku detar joni-5, ndërmjet ministrisë së ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës dhe medoil, plc

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

Vendosi:

1. Miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, blloku detar Joni-5, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe MEDOIL, plc, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryeministri

Sali Berisha